



Nr. 1711/Rep, Nr. 546 Kol.

Elbasan, me 06.11.2006

KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Ne Elbasan, sot ne date 06.11.2006 (gjashte nentor dymijegjashte) perpara meje noteres Enkelejda Marinaj, me qender te veprimtrise ne Lagjen "5 Maj" te qytetit te Elbasanit, prane Gjykates se Rrethit Gjyqsor Elbasan, u paraqiten kontraktuesit si pale:

Me cilesine e shitesit : **ARBEN TERZIU**, i biri i Arifit dhe i Sanijes, dtl.06.07.1963, lindur ne Elbasan me banim ne Austri, mbajtes i pasaportes austriake nr.C0010974 3, leshuar me 12.09.1997.

Me cilesine e bleresit: **FEIM KADI**, i biri i Safetit dhe i Mines, dtl.02.04.1949, lindur ne Korce e banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes nr.Z1023446, leshuar me 30.04.2004.

Qe te dy madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje, me pembajtje si me poshte vijon:

Objekti i kontrates : Shitblerje kuotash te shoqerise "TERZIU" shpk.

Baza ligjore : Neni 705 e vijues i K.Civil, Ligji 7638, date 19.11.1992, Ligji nr.7667, date 28.01.1993, si dhe Ligji 7829, date 01.06.1994, "Per Noterine".

Kushtet e kontrates:

Shoqeria "TERZIU" shpk, eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr.6100, date 05.09.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane, me ortak te vetem themelues z. Arif Terziu, me kapital themeltar 100% kontribut i ortakut te vetem themelues, me seli ne Lagjen "e Re" Elbasan, me afat veprimtarie 15 vjet, me administrator te shoqerise z.Arif Terziu, dhe objekt veprimtarie, sipas akt-themelimit dhe statutit te shoqerise.

Me vendimin nr.1, date 15.07.2005 te ortakut te vetem, eshte vendosur largimi nga shoqeria si ortak i z.Arif Terziu, duke u kaluar ne favor te ortakut te ri z. Arben Terziu te gjitha kuotat prej 100% te kapitalit themeltar.

Me vendimin nr.2, date 06.11.2006 te ortakut te vetem, eshte vendosur largimi nga shoqeria i ortakut te vetem z.Arben Terziu, duke u kaluar ne favor te ortakut te ri Z.Feim Kadi, te gjitha kuotat prej 100% te kapitalit themeltar.

Nepermjet kesaj kontrate, realizohet shitja nga ana e shitesit Arben Terziu dhe blerja nga ana e bleresit Feim Kadi e teresise prej 100% te kuotave te kapitalit themeltar.

Shitesi Arben Terziu deklarom se 100 % te kuotave te kapitalit themeltar, ia shet bleresit Feim Kadi

Bleresi Feim Kadi, deklarom se eshte dakort te bleje nga shitesi 100% te kuotave te kapitalit themeltar.

Palet deklarojne se jane shlyer totalisht me njera tjetren jashte kesaj zyre noterie.


Me lidhjen e kesaj kontrate, shitesi zhvishet nga pronesia mbi te gjitha kuotat e kapitalit themeltar, pronesi kjo qe i kalon bleresit, i cili behet ortak i vetem i shoqerise, duke zoteruar ne kete menyre 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Per sa me sipër, redaktohet ky akt ne kater origjinale te njejte, ne perputhje te plote me vullnetin e porositesve te tij, lexohet prej tyre dhe nenshkruhet pa verejtje, nga vete ata ne pranine time noteres.

Une noterja, e vertetoj.


SHITESI

ARBEN TERZIU



BLERESI

FEIM KADI



NOTERE

Enkelejda Marinaj

